



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 361/2024
Datë: 14 / 10 .2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019) dhe nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 08/L-149, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-272, në pajtim me nenin 2 të Udhëzimit Administrativ MD-nr. 01/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-nr. 09/2019 për kushtet e zyrës noteriale, hapësirat dhe pajisjet, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arësim Avdiaj, noter në territorin e Komunës së Pejës, caktohet që të kryejë shërbime noterial në Komunën e Klinës.
2. Noteri i caktuar në pikën 1 të këtij vendimi obligohet që të hapë një zyrë të re në komunën e autorizuar dhe orari i ofrimit të shërbimit noterial do të jetë në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Noteri i caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet që shërbimet noteriale t'i ofrojë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga nxjerrja e këtij vendimi.
4. Vendimi vlen për periudhën kalimtare deri në kompletimin e shërbimit noterial në Komunën e Klinës.
5. Vendimi hyn në fuqi me datë 18.10.2024.



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi palët mund të iniciojnë konfliktin administrativ brenda afatit të përcaktuar ligjor në gjykatën kompetente.

Vendimi iu dërgohet:

- *Noterit të caktuar z. Arësim Avdiaj;*
- *Odës së Noterëve të Kosovës;*
- *Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Klinë;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Departamentit për Profesione të Lira/MD;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*